

VENDIM
Nr. 638, datë 31.7.2013

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT,
DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR. 46684/07 DHE NR. 34770/09,
“MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e pjesshëm të vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të paguhet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe për të përlogaritur vlerën në euro të detyrimit të shlyer të mbahet në konsideratë kursi i këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

Pjesa e mbetur e detyrimit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, të paguhet sipas afateve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Ministria e Financave të marrë masat e nevojshme për gjetjen e mundësisë financiare për ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit, brenda afateve sa më të shpejta. Ministria e Financave njofton Ministrinë e Drejtësisë për nisjen e procedurave për ekzekutimin e detyrimit në varësi të mundësisë financiare për përballimin e saj.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, në vlerë proporcionale me detyrimin që ka shteti shqiptar për secilin prej tyre, sipas vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondet e papërdorura të KQZ-së për mosaplikimin e dy projekteve të teknologjisë për procedurat zgjedhore sipas vendimit nr. 372, datë 3.5.2013 të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23 qershor 2013”.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha